



Pranuar / Dorezuar Prenjeno / Predato Received / Delivery	05.04.2022	2	viti god Year
Organ / Shënia Organ / Shënia Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSTOK	1894/2022		112

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.149/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bektoshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.149/2022 të datës 22.02.2022 e parashtruar nga ankuesi

me adresë _____ në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, kundër organit të punësimit Komuna e Fushë Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 05.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pa lejuar ankesa me numër A.nr.149/2022 e datës 22.02.2022, e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Komunën e Fushë Kosovës në pozitën “*Auditor i Brendshëm*”, sipas Akt Emërimit pa afat me numër 729 të datës 07.07.2016 me gradën 8, me datë 22.02.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 919/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke kërkuar diferencën e pagës prej periudhës 01.02.2012 kur është emëruar Auditor i Brendshëm me koeficient 8 deri në shkurtë të vitit 2014.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa me datë 15.03.2022, Komuna e Fushë Kosovës ka përcjell dokumentacionin lidhur me këtë lëndë faqe 1/5.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 22.02.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i ankuesit i datës 29.02.2012; Vendimi i datës 01.02.2012; Akt emërimi i ankuesit i datës 10.03.2014; Akt emërimi i datës 07.07.2016; Kartela e nëpunësit për vitin 2012, 2013 dhe 2014; Kopja e letër njoftimit si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/5.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjes e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është e **jasht afatit ligjor, sepse:**



Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit dhe ka konstatuar se në bazë të Akt Emërimit me numër 111 ankuesi akt emërimin për vendin e punës "Auditor i Brendshëm", e ka nënshkruar me datë 29.02.2012 ndërsa Akt emërimin me numër 138 për vendin e punës "Auditor i Brendshëm" e ka nënshkruar me datë 10.03.2014, ankuesi që nga data 10.03.2014 që e ka nënshkruar Akt emërimin me numër 138, nuk ka ndërmarr asnjë veprim ligjor, respektivisht ankuesi nuk ka ofruar as një dëshmi që ka parashtruar ankesë apo kërkesë në kuadër të institucionit të punësimit po ashtu një gjë të tillë e ka konfirmuar edhe organi i punësimit me rastin e kthimit të përgjigjes në ankesë për Këshillin me datë 15.03.2022, andaj Kolegji ka konstatuar se ankuesi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat nenit 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave ku përcaktohet se: „Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi e ka nënshkruar me datë 10.03.2014 Akt emërimin me numër 138, ndërsa me datë 22.02.2022 ankuesi ka parashtruar ankesë me numër protokollit 919/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesa e ankuesit është e palejuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.149/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Fushë Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

